



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4422/12 Prot

Gramsh më. 26.11.2021

VENDIM

Nr.124, datë 26.11.2021

PËR

“ Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti datës 26.11.2019, si dhe shirat e rënë gjatë muajit Tetor të viti 2021 në banesën e z. Avni Basha, banor në fshatin Tunjë Qendër, Njësia Administrative Tunjë, si dhe dëmshpërblimin financiar”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 26.11.2021, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti I datës 26.11.2019, si dhe shirat e rënë gjatë muajit Tetor 2021, në banesën e shtetasit Z. Avni Basha, banor në Fshatin Tunjë Qendër, Njësia Administrative Tunjë, si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është 50% të vlerës së preventivit të përlllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. $883\ 248 \times 40\% = 353\ 299$ lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin Z. Avni Basha është 353 299 (treqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.
3. Ti akordoj familjes së shtetasit Avni Basha, ndihmën emergjente në vlerën prej


353 299 (treqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë nga buxheti i bashkisë Gramsh, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2021.

4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Avni Basha, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për të ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Avni Basha, banesa e të cilit është dëmtuar nga forca madhore tërmeti i datës 26.11.2019, si dhe nga shirat e rënë gjatë muajit Tetor 2021.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike (Sektori i Emergjencave Civile), si dhe Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.


Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI



Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes:



KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

GRETA LENA

